

S I L L A B U S

| | |
|---|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti Filozofik – Dega e Historisë (Universiteti i Prishtinës) |
| Titulli i lëndës: | HISTORI BOTËRORE MODERNE shek. XIX-1918 |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | III - semestri veror (i gjashtë) |
| Numri i orëve në javë: | 3+2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 5 |
| Koha / lokacioni: | E martë, 09:00-11:15, salla nr. 14 |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. dr. Gazmend Rizaj |
| Detajet kontaktuese: | gazmend.rizaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | Kjo lëndë është vazhdim kronologjik i Modernitetit të Hershëm, por që si rezultat i Iluminizmit dhe Revolucionit Borgjez Francez të vitit 1789 kjo periudhë hyn në një fazë të re, e njohur si Modernitet i Vonshëm. Çështjet kyçe që do të vihen në diskutim gjatë ligjëratave do të jenë: Shekulli i Napoleonit; Zhvillimi industrial dhe fillet e globalizmit në rrafshin ekonomik dhe kulturor; Bashkimi i Italisë dhe Gjermanisë; Çështja Lindore – Perandoria Osmane përballë Pansllavizmit; Imperializmi dhe ndarja e re e Botës; Sistemi i aleancave dhe diplomacia evropiane; Krizat ndërkombëtare në prag të Luftës së Parë Botërore; Bota në Luftë. |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi i kësaj lënde është që studentit t’i ofrohen shpjegime për konceptet historiografike mbi shekullin XIX dhe fillimin e shekullit XX, pra një elaborim konciz i proceseve kryesore të cilat e shpënë Botën në një zhvillim marramendës ekonomik, shoqëror dhe kulturor, duke mos e lënë në harresë as shfaqjen e imperializmit i cili rezultoi me implikimin e Botës në Luftën e Parë Botërore. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Studentët që vijojnë këtë lëndë: <ul style="list-style-type: none"> • Do ta kuptojnë lidhshmërinë e fenomeneve ekonomike, sociale, kulturore, politike dhe religjioze të periudhës moderne me atë bashkëkohore dhe njëkohësisht do të jenë në |

| | <p>gjendje të bëjnë krahasime të drejta;</p> <ul style="list-style-type: none"> do të kenë mundësi t'i diskutojnë konceptet themelore të shkencës së shekullit XIX; Do të jenë në gjendje ta kuptojnë dhe ta diskutojnë fenomenin e globalizimit por edhe arsyet që e shpënë Botën drejt konfrontimit global - Luftës së Parë Botërore. | | |
|---|---|------------------|-----------------------|
| Kontributi në ngarkesën e studentit - korrespondon me rezultatet e të nxëniet të studentit | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej - orë |
| Ligjërata | 3 | 15 javë | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 javë | 30 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0.30 | 10 ditë/javë | 5 |
| Ushtrime në terren | | | |
| Kollokviume, seminare | 4 | 2 ditë/javë | 8 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 3 ditë | 3 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 14 ditë/2 javë | 14 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 5 ditë | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 1 | 2 javë | 2 |
| Projektet, prezentimet, etj. | 2 | 4 ditë | 8 |
| Totali | | | 125:25= 5 ECTS |
| Metodologjia e mësimdhënies: | Ligjëratat janë interaktive. Gjatë ligjëratarave studentët kanë mundësi të debatojnë mbi çështjet e trajtuara nga ana e mësimdhënësit por edhe gjatë prezentimit të eseve dhe projekteve seminarike nga studentët. Esetë punohen individualisht apo në grupe. Mësimdhënia zhvillohet nëpërmjet video-projektorit me programin <i>PowerPoint Presentation</i> . | | |
| Metodat e vlerësimit: | <ul style="list-style-type: none"> Vijimi i rregullt 5% Kollokviumi 1 10% Kollokviumi 2 15% Aktiviteti në ligjërata 5% Punimi seminarik 10% Provimi final 55% Totali 100% | | |

| Literatura | |
|---------------------------|--|
| Literatura bazë: | Romeo Gurakuqi, HISTORIA E KOHËS SË RE, 2 - Qytetërimi Perëndimor (1775-1871), Shkodër 2004; Menduh Derguti & R. Gurakuqi, HISTORIA E KOHËS SË RE, 3 - Qytetërimi Perëndimor (1871-1918), Tiranë, 2004; Karl Grimberg, HISTORIA BOTËRORE DHE QYTETËRIMI, vëll.9-11, Tiranë, 2005; Stanford J. Shaw & Ezel Kural Shaw, HISTORIA E PERANDORISË OSMANE DHE E TURQISË MODERNE, II, Tiranë, 2006; Norman Rich, Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914, Tiranë, 2006. A.Gani & I.N.Sulo, HISTORIA E SHEKULLIT XIX, Tiranë 1999. |
| Literatura shtesë: | S. Stavrianos, THE WORLD SINCE 1500 – A GLOBAL HISTORY, New Jersey, 1991; Robert Gildea, BARRICADES AND BORDERS – EUROPE 1800-1914; George Rude, REVOLUTIONARY EUROPE 1783-1815, The Fontana History of Europe, Glasgow (bot.1-1964 – bot.15-1978); Robert A. Kann, A HISTORY OF THE HABSBURG EMPIRE 1526-1918, Berkeley/Los Angeles/London, 1984; A J P Taylor, THE HABSBURG MONARCHY 1908-1918, London, 1990 Lord Kinross, THE OTTOMAN CENTURIES The Rise and Fall of the Ottoman Empire, New York, 1977; Martin Gilbert, A HISTORY OF TWENTIETH CENTURY, .Volume:1900-1933, Harper Collins Publishers 1997; Winston S. Churchill, FRONTE DHE LUFTËRA 1897-1900, vëll. I dhe II, Tiranë, 2006; August Boppe, NAPOLEONI DHE ALI PASHA, Tiranë, 1999; Henry Dunant, NJË KUJTIM NGA SOLFERINO, Prishtinë, 1995; Giuliano Procacci, HISTORIA E ITALIANËVE, Tiranë, 2000; E.H. Gombrich, HISTORIA E ARTIT, 1996; Peter F. Sugar, EUROPA JUGLINDORE NËN SUNDIMIN OSMAN 1354-1804, Tiranë, 2007. Emil Ludvig, KORRIK 1914, Tiranë, 2001. Preferohet po ashtu shfrytëzimi i Internetit. |

| Plani i dizajnuar i mësimi | |
|----------------------------|---|
| Javët e ligjëratave | Temat e ligjëratave |
| Java e parë: | Diskutim i sillabusit |
| Java e dytë: | Impakti i Revolucionit Francez dhe Shekulli i Napoleonit |
| Java e tretë: | Kongresi i Vjenës 1815 |
| Java e katërt: | Industrializimi dhe Nacionalizmi 1800-1870: Revolucioni industrial; Reaksioni dhe Revolucioni; Nacionalizmi; Liberalizmi, Socializmi |
| Java e pestë: | Shoqëria, shkenca dhe kultura evropiane e shek. XIX: Romantizmi dhe Realizmi në Evropën Perëndimore |
| Java e gjashtë: | KOLLOKVIUMI 1. |

| | |
|------------------------------|--|
| Java e shtatë: | Azia dhe Afrika në shekullin XX: Rusia; Lindja e Mesme dhe e Largët – impakti i Evropës; Afrika: tregtia me skllëvër, copëtimi i Afrikës, impakti i Evropës |
| Java e tetë: | Përfundimi i themelimit të shteteve nacionale në Evropën Perëndimore: Unifikimi i Italisë |
| Java e nëntë: | Përfundimi i themelimit të shteteve nacionale në Evropën Perëndimore: Unifikimi i Gjermanisë |
| Java e dhjetë: | Marrëdhëniet ndërkombëtare 1871-1907: krijimi i blloqeve politike antagoniste |
| Java e njëmbëdhjetë: | Perandoria Osmane në shek. XIX: “Çështja Lindore” |
| Java e dymbëdhjetë: | Kontinenti amerikan në shek. XIX |
| Java e trembëdhjetë: | KOLLOKVIUMI 2. |
| Java e katërbëdhjetë: | Krizat ndërkombëtare të fillimit të shek. XX dhe Lufta e Parë Botërore |
| Java e pesëmbëdhjetë: | Rekapitullim i ligjëratave dhe diskutim |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

- Hyrja me kohë në ligjëratat - e domosdoshme. Vonesa mbi 10 minuta nuk justifikohet;
- Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë ligjëratat;
- Kopjimi me rastin e kollokviumeve dhe provimit final - i pajustificueshëm;
- Shfrytëzimi jo i drejtë i burimeve (plagjiati etj.) me rastin e hartimit të esëve, punimeve seminarike etj. - i ndaluar dhe ndëshkohet;
- Çdo kontakt lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse - në orën e konsultimeve dhe nëpërmjet e-mail adresës zyrtare.